

ZËRI I TË RINJVE NË KUKËS

- RAPORT -

---

# ZËRI I TË RINJVE NË KUKËS

## - RAPORT -

Analizimi & Përpunimi i informacionit nga takimet në komunitet, politikat rinore, perceptimi i të rinjve në Kukës



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC



## Në Fokus

Këshilli Rajonal Rinor Kukës, me mbështetjen e **LëvizAlbania** dhe Agjensisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, në kuadër të iniciativës “Angazhimi Rinor në Komunitet”, realizon këtë raport vlerësues, me synim evidentimin e nevojave reale të të rinjve në Kukës, si paraqitet situata e tyre në komunitet, cilat janë sugjerimet konkrete që ata kanë për institucionet lokale dhe sa dëgjohen ata nga këto institucione, në këtë rast publikimi i këtij raport synon të krijojë ura lidhëse komunikuese të qarta midis komunitetit dhe qeverisë lokale në Kukës si nevojë për të rritur angazhimin sidomos të të rinjve në komunitet duke propozuar nisma konkrete në mbështetje të nismave rinore. Qëllimi i kësaj nisme është angazhimi i të rinjve në Kukës si katalizatorë ndryshimi për përmirësimin e situatës së tyre në komunitet nëpërmjet monitorimit, lobimit dhe sugjerimit të nismave për rininë.

Takimet me komunitetin kanë patur si objektiv përcimin e zërit të të rinjve në institucionet politkubërëse dhe ndërgjegjësimin dhe informimin e tyre për rëndësinë e pjesëmarrjes në komunitet dhe rolit të rëndësishëm që ata kanë për përmirësimin e situatës. Në këtë mënyrë ata do të kenë më tepër informacion rreth potencialit që disponojnë për të qenë aktorë ndryshimi për shoqërinë e tyre.

Si pjesë e rëndësishme për realizimin e iniciativës, KRRK ka realizuar me komunitetin pytesorë informues të cilët kanë patur synimin jo vetëm për të evidentuar nevojat reale të të rinjve, cilat janë perceptimet e tyre, por edhe për të dhënë sugjerime konkrete për institucionet për ato çështje që kanë nevojë të përmirësohen në komunitet, sugjerime këto që janë perkthyer në shkrimin dhe përpilimin e një projekti konkret i cili do të prezantohet në Këshillin Bashkiak dhe Bashkinë Kukës dhe për të cilin do të llobohet me synim realizimin e tij.

Duke qenë se për realizimin e punës së Këshillit Rajonal Rinor Kukës është vlerësuar gjithnjë si tepër me rëndësi kontakti me komunitetin, në kuadër të iniciativës “Angazhimi Rinor në Komunitet” janë zhvilluar disa takime në zona të ndryshme të Kukësit, në zonat rurale dhe në qytet. Nga vëzhgimet e KRRK, përmbledhtasi është evidentuar se qytetarët dhe sidomos të rinjtë në Kukës nuk angazhohen në çështje që kanë të bëjnë me komunitetin kjo për disa arsye që janë të lidhura kryesisht me aksesin e pakët në informacion dhe hendekun që ekziston mes komunitetit dhe qeverisë lokale. Këtu duhet të luajnë një rol më të madh institucionet arsimore dhe politkubërëse që t’i orientojnë të rinjtë për të drejtat që ata kanë si qytetarë, pasi ndër faktorët kryesorë paraqitet mosbesueshmëria që ka komuniteti te institucionet të cilat duhet të bëjnë më shumë për të krijuar ura lidhëse mes tyre.

Grupi i punës dhe anëtarët e KRRK kanë zhvilluar 6 takime me komunitetin konkretisht në fshatrat: Gostil, Shishtavec, Bardhoc, Bicaj dhe dy takime në Kukës qytet, pranë Konviktit të shkollës së mesme si edhe pranë gjimnazit “Havzi Nela”. Periudha e realizimit të këtyre takimeve dhe mbledhja e të dhënave nga pyetësorët është zhvilluar në muajt Dhjetor 2016 - Shkurt 2017. Duke patur parasysh interesin e madh nga komuniteti për këtë iniciativë, në takimin e realizuar me të rinjtë në të gjitha zonat ku janë zhvilluar forumet, është evidentuar një pjesëmarrje më e madhe nga numri i menduar paraprakisht në projekt, kjo edhe për arsye të numrit tepër të kufizuar me aktivitete të këtij lloji pra ku kërkohet angazhimi i komunitetit, evidentuar sidomos në zonat rurale.

## Vështrim mbi situatën e të rinjve në Kukës

Shqipëria, në krahasim me vendet e tjera evropiane, vazhdon të mbetet një vend me moshë mesatare të re, ku rreth 25% e popullatës dominohet nga mosha 15-29 vjeç, duke përbërë grupimin më të madh të forcës aktive në shoqëri dhe forcës së aftë për punë. Shqipëria paraqet një potencial të jashtëzakonshëm zhvillimi, nëse investohet në mënyrën e duhur tek të rinjtë dhe tek perspektiva e tyre<sup>1</sup> prandaj është tepër e rëndësishme që të rinjtë të vlerësohen dhe mbështeten siç duhet nga të gjitha institucionet. Konkretisht, Bashkia Kukës krahasuar edhe në rang vendi, përbëhet nga një popullsi e re duke paraqitur kështu një potencial shumë të madh zhvillimi për shoqërinë dhe rajonin e Kukësit.

Anëtarët e KRRK dhe grupi punës duke vlerësuar këto karakteristika në lidhje me të rinjtë e Kukësit, kanë vëzhguar nga afër situatën e tyre në komunitet për të evidentuar se sa të përfshirë janë të rinjtë, sa dëgjohe zëri i tyre në komunitet dhe çfarë propozojnë vetë ata për përmirësimin e situatës.

Ne vlerësojmë se *nevoja për rritjen e angazhimit të të rinjve në përpilimin e politikave dhe projekteve rinore diktohet kryesisht në lidhje me disa çështje:*

- ✓ Për arsye numerike, pasi të rinjtë përbëjnë rreth 25% të popullsisë.
- ✓ Nevoja për të sjellë ide të reja, një frymë më bashkëkohore, për të çliruar qarqet e mbyllura të vendimmarrjes tradicionale.
- ✓ Nevoja që institucionet të identifikojnë problemet reale dhe të përpilojnë buxhetet reale mbi këto baza duke rritur nivelin e llogaridhënies dhe transparencës ndaj publikut.
- ✓ Adresimi i pasivitetit në angazhim, duke filluar që nga pjesëmarrja në zgjedhje, nga përfshirja apo puna në komunitet, vullnetarizmi, deri tek pjesëmarrja në hartimin e politikave lokale, zgjedhja në forumet lokale, të lagjes, etj;
- ✓ Ndryshimi i ambientit shoqëror i cili është i polarizuar dhe përqëndrimi në çështjet e komunitetit. Për politikë dhe vendimmarrje flitet kudo, pasi ajo është e lidhur pikë së pari me kushtet e jetesës, por aktivizimi i të rinjve në çështjet e komunitetit rrit ndërvëprimin mes tyre, si edhe përmirëson situatën reale të tyre në komunitet.

Duke patur parasysh këto arsye, KRRK ka zhvilluar disa forume me të rinjtë në komunitet duke biseduar e dëgjuar shqetësimet, sugjerimet dhe idete e tyre në lidhje me situatën e tyre në komunitet për çështje që kanë të bëjnë me shkollimin e tyre, infrastrukturën, punësimin, sigurinë etj, por edhe për ndërgjegjësimin për rëndësinë e angazhimit të tyre për çështjet e komunitetit, cilat janë të drejtat e tyre për informim e konsultim dhe mjetet që ata mund të përdorin për të ushtuar presion ndaj qeverisë lokale. Takime janë realizuar në formë debati dhe bashkëbisedimi ku të gjithë të kishin të drejtën e fjalës, realizuar kjo edhe nëpërmjet pyetësorëve të shpërndarë në çdo takim.

Në këto takime është vlerësuar posaçërisht informimi i të rinjve për të drejtat dhe detyrat e tyre në komunitet, si mund të akvizohen konkretisht dhe funksionet dhe detyrimet e Bashkisë së Kukësit dhe Këshillit Bashkiak për shërbimin ndaj komunitetit.

Të rinjtë kanë shprehur interes të madh për të parë se si funksionojnë mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe se **88%** e tyre janë të gatshëm të jenë pjesëmarrës në këto takime edhe pse është venë re se pjesa më e madhe, nuk kanë informacion në lidhje me të drejtën e tyre për informim dhe se ka ende një hendek të madh përsa i përket pjesëmarrjes qytetare dhe Bashkisë. Pjesë e rëndësishme e diskutimit me të rinjtë në komunitet kanë

<sup>1</sup> Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë, fq.6: [http://www.sociale.gov.al/files/documents\\_files/plani\\_kombetar\\_i\\_veprimit\\_per\\_rinine\\_shqip.pdf](http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/plani_kombetar_i_veprimit_per_rinine_shqip.pdf)

qenë edhe se cilat janë disa nga hapat që të rinjtë mund të ndërmarrin për të rritur pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre, si:


1. Duke u bërë vullnetarë në fushën që u pëlqen dhe aktivizuar edhe në shkollën e tyre në lidhje me çështje të caktuara të komunitetit
2. Duke marrë pjesë në dëgjuesat dhe takimet me publikun
3. Duke u regjistruar si votues dhe duke ushtruar të drejtën e votes
4. Duke organizuar dhe drejtuar të rinjtë e tjerë në komunitetin përkatës në iniciativa të ndryshme
5. Duke u bërë pjesë e diskutimit dhe hartimit të politikave
6. Duke marrë pjesë në proceset vendimmarrëse e duke dhënë mendimin përkatës për to etj.

Informimi i qytetarëve për të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre është hapi i parë për rritjen e angazhimit të tyre në komunitet. Shpesh kjo formë përdoret vetëm në një drejtim, nga zyrtarët tek qytetarët pa parashikuar një kanal komunikimi që të garantojë përcjelljen e mendimit të të rinjve. Kjo formë nuk lejon qytetarët që të negocjojnë me vendimmarrësit. Në këto kushte, në çdo planifikim strategjik, qytetarët kanë mundësi të pakta për të influencuar në programet dhe veprimet që zhvillohen “për të mirën e tyre”.

Përsa i përket situatës së të rinjve institucionet nga ana e tyre mund të themi kanë ende për të përmirësuar pasí situata e të rinjve paraqitet ende e vështirë. Problematikat kryesore janë evidentuar edhe nga pyetësorët që KRRK ka zhvilluar nga takimet me të rinjtë në komunitet dhe të dhënat paraqesin disa aspekte që kanë nevojë për ndërhyrje sa më parë.

### Rezultatet e evidentuara nga pyetësorët

Grupi i KRRK ka realizuar 6 takime në zona të ndryshme të Kukësit duke patur në konsideratë si zonat urbane ashtu edhe ato rurale për zhvillimin e forumeve me komunitetin specifikisht në fshatrat Gostil, Shishtavec, Bardhoc, Bicaj dhe dy takime në Kukës qytet, pranë Konvktit të shkollës së mesme si edhe pranë gjimnazit “Havzi Nela”. Të rinjtë në këto takime kanë evidentuar disa nga problemet më kryesore pavarësisht se kërkesa e tyre në shumë raste ka qenë për përmirësimin e të gjitha problematikave të sugjeruara në pyetësor. Megjithatë, mund të themi në vështrim të përgjithshëm se kushtet e vështira në shkolla dhe infrastruktura arsimore e dobët, mospasja e laboratorëve dhe qendrave rinore, varfëria, infrastruktura rrugore, papunësia dhe vështirësitë në transport janë çështjet më të diskutuara dhe për të cilat sugjerohet ndërhyrja sa më parë nga institucionet lokale.



Gjithashtu, të rinjtë sugjerojnë edhe mënyrat më të përshtatshme për të qenë më aktivë në komunitet, ku nga opsionet e ofruara nga KRRK pjesa më e madhe mendon se një pjesëmarrje më e madhe në mbledhjet e KB, është e nevojshme për të patur më tepër informacion dhe e sheh si mënyrën më të përshtatshme për zgjidhjen e problematikave. Bazuar në rezultatet e pyetësorëve, **88% e të intervistuarve pohojnë se kanë dëshirë të jenë pjesëmarrës në mbledhjet e këshillit bashkiak**, shifër kjo që duhet konsideruar realisht në përpilimin dhe zhvillimin e punës për përmirësimin e standartit dhe kontaktet për komunikimin me publikun nga të gjithë aktorët e rëndësishëm politikbërës dhe institucionet përgjegjëse.


## Rezultatet e evidentuara nga pyetësorët

Duke analizuar të dhënat nga rezultatet e pyetësorëve, mund të dallojmë lehtësisht se të rinjtë përgjithësisht në Kukës, kanë të njëjtat kërkesa dhe problematika në shumicën e zonave të intervistuar të cilat mund të themi se janë të shumta dhe shpesh herë në pyetësorët është vëne re se të rinjtë kanë përzgjedhur të gjitha alternativat e propozuara dhe për të cilat është e nevojshme ndërhyrja për përmirësim nga Bashkia.

## Fshati Gostil


## 1 - Cilat janë disa nga problemet më kryesore që ka komuniteti / lagjja juaj?

(Ju lutem rrethoni problemet më kryesore)




- 1 - Nuk ka një qendër kulturore për të rinjtë/komunitetin
- 2 - Akses i ulët në shërbimin shëndetësor
- 3 - Nuk ka një bibliotekë të re/ ose përmirësimin e asaj aktuale me ambiente të përshtatshme për të patur edhe akses në kompjutera
- 4 - Akses i ulët në shërbimin arsimor
- 5 - Vështirësi transporti për të rinjtë nga rrethinat e qytetit
- 6 - Infrastruktura/rrugët në gjendje jo të mire dhe ndriçimi tyre
- 7 - Mjedisi i varfë
- 8 - Papunësia
- 9 - Siguria/krimi
- 10 - Kushte të vështira në shkollë

## 2 - Cila mendoni se mund të ishte zgjidhja më e mirë për problematikat e paraqitura më lartë në zonën tuaj / Cili mendoni se mund të ishte kontributi juaj?




- Duke marrë pjesë aktive në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe në seancat që organizohen për këshillimin me qytetarët
- Takime të hapura me banorët e grupet e interesit
- Duke drejtuar një kërkesë/ ankesë pranë institucioneve vendore
- Duke paraqitur për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje të komunitetit
- Organizimi i një peticioni me firma
- Kontributi vullnetar në përmirësimin e një problemi

3 - Sa të informuar jeni për të drejtat që kanë qytetarët për të marrë pjesë aktive në mbledhjet e Këshillit Bashkiak të



- Kam informacion
- Jam pjesë aktive si qytetar/e në mbledhjet e Këshillit Bashkiak
- Nuk kam informacion për të drejtën për të marrë pjesë e këtyre mbledhjeve
- Nuk jam e/i interesuar

4 - Keni marre ndonjëherë pjesë në një mbledhje të Këshillit Bashkiak?



- Jo, por do kisha dëshirë të merrja pjesë
- Nuk kam informacion për të drejtën për të marrë pjesë e këtyre mbledhjeve
- Tjetër (specifiko)


5 - Keni tentuar të zgjidhni ndonjë problematikë në komunitetin tuaj duke kontaktuar me institucionet në Kukës?

psh: duke drejtuar ndonjë kërkesë, letër apo ankesë për përmirësimin e një situatë të caktuar?



- 1 - Po, gjithmonë
- 2 - Po, rrallë
- 3 - Jo
- 4 - Nuk kam besim
- 5 - Tjetër (specifiko)

6 - Kush punon më shumë për zgjidhjen e problemeve të komunitetit?




- Burrat (8.91%)
- Gratë (1.98%)
- Njësoj si burat & gratë (30.69%)
- Të Rinjtë (43.56%)
- Asnjë (14.85%)

Fshati Shishtavec


1 - Cilat janë disa nga problemet më kryesore që ka komuniteti / lagjja juaj?

(Ju lutem rrethoni problemet më kryesore)



- 1 - Nuk ka një qendër kulturore për të rinjtë/komunitetin
- 2 - Akses i ulët në shërbimin shëndetësor
- 3 - Nuk ka një bibliotekë të re/ ose përmirësimin e asaj aktuale me ambiente të përshtatshme për të patur edhe akses në kompjutera
- 4 - Akses i ulët në shërbimin arsimor
- 5 - Vështirësi transporti për të rinjtë nga rrethinat e qytetit
- 6 - Infrastruktura/rrugët në gjendje jo të mire dhe ndriçimi tyre
- 7 - Mjedisi i varfë
- 8 - Papunësia
- 9 - Siguria/krimi


2 - Cila mendoni se mund të ishte zgjidhja më e mirë për problematikat e paraqitura më lartë në zonën tuaj / Cili mendoni se mund të ishte kontributi juaj?



- Duke marrë pjesë aktive në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe në seancat që organizohen për këshillimin me qytetarët
- Takime të hapura me banorët e grupet e interesit
- Duke drejtuar një kërkesë/ ankesë pranë institucioneve vendore
- Duke paraqitur për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje të komunitetit
- Organizimi i një peticioni me firma




### 3 - Sa të informuar jeni për të drejtat që kanë qytetarët për të marrë pjesë aktive në mbledhjet e Këshillit Bashkiak të



- Kam informacion
- Jam pjesë aktive si qytetar/e në mbledhjet e Këshillit Bashkiak
- Nuk kam informacion për të drejtën për të marrë pjesë e këtyre mbledhjeve
- Nuk jam e/i interesuar


### 4 - Keni marre ndonjëherë pjesë në një mbledhje të Këshillit Bashkiak?



- Jo, por do kisha dëshirë të merrja pjesë
- Nuk kam informacion për të drejtën për të marrë pjesë e këtyre mbledhjeve
- Tjetër (specifiko)


### 5 - Keni tentuar të zgjidhni ndonjë problematikë në komunitetin tuaj duke kontaktuar me institucionet në Kukës?

psh: duke drejtuar ndonjë kërkesë, letër apo ankesë për përmirësimin e një situatë të



- 1 - Po, gjithmonë
- 2 - Po, rrallë
- 3 - Jo
- 4 - Nuk kam besim
- 5 - Tjetër (specifiko)

### 6 - Kush punon më shumë për zgjidhjen e problemeve të komunitetit?




- Burrat (33%)
- Gratë (3%)
- Njësoj si burat & gratë (41%)
- Të Rinjtë (16%)
- Asnjë (7%)

Fshati Bardhoc


1 - Cilat janë disa nga problemet më kryesore që ka komuniteti / lagjja juaj?

(Ju lutem rrethoni problemet më kryesore)




- 1 - Nuk ka një qendër kulturore për të rinjtë/komunitetin
- 2 - Akses i ulët në shërbimin shëndetësor
- 3 - Nuk ka një biblioteke të re/ ose përmirësimin e asaj aktuale me ambiente të përshtatshme për të patur edhe akses në kompjutera
- 4 - Akses i ulët në shërbimin arsimor
- 5 - Vështirësi transporti për të rinjtë nga rrethinat e qytetit
- 6 - Infrastruktura/rrugët në gjendje jo të mire dhe ndriçimi tyre
- 7 - Mjedisi i varfë
- 8 - Papunësia
- 9 - Siguria/krimi

2 - Cila mendoni se mund të ishte zgjidhja më e mirë për problematikat e paraqitura më lartë në zonën tuaj / Cili mendoni se mund të ishte kontributi juaj?




- Duke marrë pjesë aktive në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe në seancat që organizohen për këshillimin me qytetarët
- Takime të hapura me banorët e grupet e interesit
- Duke drejtuar një kërkesë/ ankesë pranë institucioneve vendore
- Duke paraqitur për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje të komunitetit
- Organizimi i një peticioni me firma

### 3 - Sa të informuar jeni për të drejtat që kanë qytetarët për të marrë pjesë aktive në mbledhjet e Këshillit Bashkiak të



- Kam informacion
- Jam pjesë aktive si qytetar/e në mbledhjet e Këshillit Bashkiak
- Nuk kam informacion për të drejtën për të marrë pjesë e këtyre mbledhjeve
- Nuk jam e/i interesuar


### 4 - Keni marre ndonjëherë pjesë në një mbledhje të Këshillit Bashkiak?



- Jo, por do kisha dëshirë të merrja pjesë
- Nuk kam informacion për të drejtën për të marrë pjesë e këtyre mbledhjeve
- Tjetër (specifiko)


### 5 - Keni tentuar të zgjidhni ndonjë problematikë në komunitetin tuaj duke kontaktuar me institucionet në Kukës?

psh: duke drejtuar ndonjë kërkesë, letër apo ankesë për përmirësimin e një situatë të



- 1 - Po, gjithmonë
- 2 - Po, rrallë
- 3 - Jo
- 4 - Nuk kam besim
- 5 - Tjetër (specifiko)


### 6 - Kush punon më shumë për zgjidhjen e problemeve të komunitetit?



Kukës Konvikti “20 Dëshmorët”


1 - Cilat janë disa nga problemet më kryesore që ka komuniteti / lagjja juaj?

(Ju lutem rrethoni problemet më kryesore)




- 1 - Nuk ka një qendër kulturore për të rinjtë/komunitetin
- 2 - Akses i ulët në shërbimin shëndetësor
- 3 - Nuk ka një bibliotekë të re/ ose përmirësimin e asaj aktuale me ambiente të përshtatshme për të patur edhe akses në kompjutera
- 4 - Akses i ulët në shërbimin arsimor
- 5 - Vështirësi transporti për të rinjtë nga rrethinat e qytetit
- 6 - Infrastruktura/rrugët në gjendje jo të mire dhe ndriçimi tyre
- 7 - Mjedisi i varfë
- 8 - Papunësia
- 9 - Siguria/krimi

2 - Cila mendoni se mund të ishte zgjidhja më e mirë për problematikat e paraqitura më lartë në zonën tuaj / Cili mendoni se mund të ishte kontributi juaj?




- Duke marrë pjesë aktive në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe në seancat që organizohen për këshillimin me qytetarët
- Takime të hapura me banorët e grupet e interesit
- Duke drejtuar një kërkesë/ ankesë pranë institucioneve vendore
- Duke paraqitur për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje të komunitetit
- Organizimi i një peticioni me firma

**3 - Sa të informuar jeni për të drejtat që kanë qytetarët për të marrë pjesë aktive në mbledhjet e Këshillit Bashkiak të**



- Kam informacion
- Jam pjesë aktive si qytetar/e në mbledhjet e Këshillit Bashkiak
- Nuk kam informacion për të drejtën për të marrë pjesë e këtyre mbledhjeve
- Nuk jam e/i interesuar

**4 - Keni marre ndonjëherë pjesë në një mbledhje të Këshillit Bashkiak?**



- Jo, por do kisha dëshirë të merrja pjesë
- Nuk kam informacion për të drejtën për të marrë pjesë e këtyre mbledhjeve
- Tjetër (specifiko)

**5 - Keni tentuar të zgjidhni ndonjë problematikë në komunitetin tuaj duke kontaktuar me institucionet në Kukës?**

psh: duke drejtuar ndonjë kërkesë, letër apo ankesë për përmirësimin e një situatë të



- 1 - Po, gjithmonë
- 2 - Po, rrallë
- 3 - Jo
- 4 - Nuk kam besim
- 5 - Tjetër (specifiko)

● 2 (28%) ● 4 (16%) ● 3 (44%) ● 1 (12%)

**6 - Kush punon më shumë për zgjidhjen e problemeve të komunitetit?**




■ Burrat (31%) ■ Gratë (7%) ■ Njësoj si burat & gratë (44%) ■ Të Rinjtë (16%) ■ Asnjë (2%)

Gjimnazi “H. Nela” Kukës Qytet


1 - Cilat janë disa nga problemet më kryesore që ka komuniteti / lagjja juaj?

(Ju lutem rrethoni problemet më kryesore)




- 1 - Nuk ka një qendër kulturore për të rinjtë/komunitetin
- 2 - Akses i ulët në shërbimin shëndetësor
- 3 - Nuk ka një biblioteke të re/ ose përmirësimin e asaj aktuale me ambiente të përshtatshme për të patur edhe akses në kompjutera
- 4 - Akses i ulët në shërbimin arsimor
- 5 - Vështirësi transporti për të rinjtë nga rrethinat e qytetit
- 6 - Infrastruktura/rrugët në gjendje jo të mire dhe ndriçimi tyre
- 7 - Mjedisi i varfë
- 8 - Papunësia
- 9 - Siguria/krimi

2 - Cila mendoni se mund të ishte zgjidhja më e mirë për problematikat e paraqitura më lartë në zonën tuaj / Cili mendoni se mund të ishte kontributi juaj?




- Duke marrë pjesë aktive në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe në seancat që organizohen për këshillimin me qytetarët
- Takime të hapura me banorët e grupet e interesit
- Duke drejtuar një kërkesë/ ankesë pranë institucioneve vendore
- Duke paraqitur për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje të komunitetit
- Organizimi i një peticioni me firma

**3 - Sa të informuar jeni për të drejtat që kanë qytetarët për të marrë pjesë aktive në mbledhjet e Këshillit Bashkiak të**



- Kam informacion
- Jam pjesë aktive si qytetar/e në mbledhjet e Këshillit Bashkiak
- Nuk kam informacion për të drejtën për të marrë pjesë e këtyre mbledhjeve
- Nuk jam e/i interesuar

**4 - Keni marre ndonjëherë pjesë në një mbledhje të Këshillit Bashkiak?**



- Jo, por do kisha dëshirë të merrja pjesë
- Nuk kam informacion për të drejtën për të marrë pjesë e këtyre mbledhjeve
- Tjetër (specifiko)

**5 - Keni tentuar të zgjidhni ndonjë problematikë në komunitetin tuaj duke kontaktuar me institucionet në Kukës?**

psh: duke drejtuar ndonjë kërkesë, letër apo ankesë për përmirësimin e një situatë të



- 1 - Po, gjithmonë
- 2 - Po, rrallë
- 3 - Jo
- 4 - Nuk kam besim
- 5 - Tjetër (specifiko)

2 (12.30%) 4 (40%) 3 (35.40%) 1 (12.30%)

**6 - Kush punon më shumë për zgjidhjen e problemeve të komunitetit?**



■ Burrat (12.50%) ■ Gratë (14.06%) ■ Njësoj si burat & gratë (60.94%) ■ Të Rinjtë (9.38%) ■ Asnjë (3.13%)

### Cilat janë perceptimet reale & sa zbatohen politikat rinore?!

**Perceptimet e komunitetit:** Nga informacioni i mbledhur nga takimet në komunitet dhe pëpunimi dhe hedhja e të dhënave të pyetësorëve, evidentohen një sërë problematikash dhe prioritete që të rinjtë e komunitetit kanë në zonat ku banojnë. Çështjet dhe temat më kryesore që janë listuar nga grupi i punës janë:

- ➔ Nuk ka një qendër kulturore për të rinjtë/komunitetin;
- ➔ Akses i ulët në shërbimin shëndetësor;
- ➔ Nuk ka një biblioteke të re/ ose përmirësimin e asaj aktuale me ambiente të përshtatshme për të patur edhe akses në kompjutera etj.;
- ➔ Akses i ulët në shërbimin arsimor;
- ➔ Vështirësi transporti për të rinjtë nga rrethinat e qytetit;
- ➔ Infrastruktura/rrugët në gjendje jo të mire dhe ndriçimi tyre;
- ➔ Mjedisi i varfër;
- ➔ Papunësia;
- ➔ Siguria/krimi;
- ➔ Kushte të vështira në shkolla dhe sugjerime të tjera;

Nga këto problematika të sugjeruara paraprakisht nga KRRK është vënë re se përgjithësisht të gjitha kanë nevojë për përmirësim por ndër më të listuarat kanë rezultuar: Kushtet e vështira në shkolla dhe mospasja e laboratorëve, mospasja e qendrave rinore, infrastruktura rrugore, papunësia dhe vështirësitë në transport janë çështjet më të diskutuara dhe për të cilat sugjerohet ndërhyrja nga institucionet lokale.

### Konkluzionet kryesore nga takimet me komunitetin

- ❖ Të rinjtë nuk janë të informuar për mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe rëndësinë që ka pjesëmarrja e tyre në këto mbledhje.
- ❖ Mbi 88% e të rinjve në komunitet janë të interesuar për të qenë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak dhe për të patur më shumë informacion në lidhje me to.

Të rinjtë evidentojnë disa mënyra se si mund të jenë aktivë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe në seancat që organizohen për këshillimin me qytetarët si më të rëndësishme rezultojnë:

- a. Duke marrë pjesë aktive në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe në seancat që organizohen për këshillimin me qytetarët;
  - b. Kontributi vullnetar në përmirësimin e një problemi;
  - c. Duke drejtuar një kërkesë/ankesë pranë institucioneve vendore;
  - d. Organizimi i një peticioni me firma
  - e. Takime të hapura me banorët e grupet e interesit
  - f. Duke paraqitur për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje të komunitetit
- ❖ Edhe pse interesi për të qenë pjesë në mbledhjet e KB është i madh, mbi 75% pohojnë se nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e këtyre mbledhjeve.
  - ❖ Mbi 58% e të intervistuarve pohojnë se nuk kanë tentuar të zgjidhin ndonjë problematikë në komunitetin apo të kontaktuar me institucionet në Kukës psh. duke drejtuar ndonjë kërkesë, letër apo ankesë për përmirësimin e një situatë të caktuar, pasi nuk kanë besim se do të gjejnë zgjidhjen e duhur.



**Sa zbatohen politikat rinore:** Anëtarët e grupi i punës së Këshillit Rajonal Rinor Kukës, kanë nisur prej muajit Tetor 2016, kontaktet e vazhdueshme me përfaqësuesit e Bashkisë Kukës dhe marrin pjesë në çdo mbledhje që Këshilli Bashkiak Kukës realizon, në fokus të punës së Bashkisë. KRRK si grupim rinor, njihet dhe mbështetet nga Bashkia Kukës për pjesëmarrjen në këto mbledhje që kanë si fokus kryesor angazhimin e të rinjve në proceset vendimmarrëse.

Synimi i këtij procesi monitorues i cili është ende në vazhdimësi të punës së tij, ka si fokus njohjen me funksionimin e mbledhjet e KB, evidentimin e politikave rinore që diskutohen e zbatohen në Bashkinë Kukës, sa diskutohet në lidhje me të rinjtë në këto mbledhje, a janë të interesuar të tjerë të rinj apo grupime nga komuniteti për pjesëmarrjen në mbledhjet e KB, sa diskutohen problemet reale të këtij komuniteti etj.

---

### Nga monitorimi janë evidentuar këto konkluzione kryesore:

---

- ❖ Në zhvillimin e mbledhjeve në disa raste fjalori i përdorur nga këshilltarët dhe kryetari i Këshillit mund të konsiderohet shumë i ashpër për një institucion publik, duke vështirësuar kështu afrimin e publikut dhe sidomos të rinjve në këto mbledhje pasi të rinjtë hasin vështirësi të përshtaten në një ambient shpesh herë konfliktual.
- ❖ Të rinjtë prezentë në mbledhjet e KB janë vetëm nga grupi i KRRK, ndërsa pjesa i përket të rinjve të komunitetit nuk ka pjesëmarrës ose në ato pak raste ata janë të organizuar nga organizata të tjera në kuadër të projekteve ose si vizitorë në raste shumë të pakta.
- ❖ Në rendin e ditës, në këto mbledhje diskutohet shumë pak për të rinjtë. Të vetmet çështje që kanë të bëjnë me të rinjtë të trajtuara në mbledhjet e Këshillit gjatë periudhës së monitorimit janë ato më esenciale si dhe kufizohen në:
  - aprovimi i bursave për nxënësit me rezultate në studime;
  - furnizimi i shkollave me lëndë drusore për periudhën e dimrit;
  - miratimin e hartave të linjave të transportit për nxënësit dhe arsimtarët;
  - ndërhyrje në infrastrukturë të pjesshme të shkollave në raste vërtet të nevojshme;
- ❖ Të rinjtë nuk kanë gjetur hapsira për të folur dhe shprehur shqetësimet e tyre, pasi janë thjeshtë si vizitorë ose dëgjues në mbledhjet e KB;
- ❖ Bashkia prej dy vjetesh, kontribuon tek sistemi i mbështetjes së të rinjve (nxënës, studentë) me bursa rreth 5,000,000 Lek të reja.
- ❖ Programi për mbështetjen e Sportit (të cilin e ushtrojnë të rinjtë kryesisht) vitin e kaluar ka si buxhet 7,000,000 Lekë (për futboll, mundje, kampjone të volejbollit etj).
- ❖ Për 2017 janë miratuar në buxhet 22,000,000 për Sportin, shumica për futbollin ndërsa pjesa tjetër për mundje dhe sporte të tjera.
- ❖ Grupi i të rinjve është pritur shumë mirë nga personeli i Këshillit Bashkiak. Stafi i Këshillit e ka lejuar grupin të vëzhgonte mbledhjen në mënyrë korrekte, duke mbështetur këto iniciativa që synojnë angazhimin e të rinjve në proceset politikbërëse.

---

### Disa forma konkrete të evidentuara të aktivizimit qytetarë për të ndikuar te vendimarrësit janë:

---

- Letra<sup>2</sup> drejtuar autoritetiteve vendore, ku i bëni prezent problemin dhe u kërkon ndryshimet e nevojshme dhe të pritshme prej tyre në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë që u ngarkon ligji.

---

<sup>2</sup> <http://kukesi.gov.al/bashkia/>

- Pjesëmarrja në komisione qytetare, janë një mundësi shumë e mirë për të ngritur zërin për nevojat specifike (në përputhje me objektivat tuaja) të grupit, interesat e të cilit përfaqësoni.
- Takime me drejtues dhe të zgjedhur vendor. Këto takime ju japin mundësi të adresoni drejtëpërdrejtë tek autoriteti përgjegjës nevojat e grupit që përfaqësoni si dhe të prezantoni këndvështrimin tuaj apo të propozoni ndryshimet që ju doni të arrini.
- Pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Ligji parashikon mbajtjen e mbledhjeve të hapura për publikun, (pra mjafton që ju të dini ditën dhe orën e mbledhjes dhe mund të merrni pjesë në mbledhje), ndërkohë që po sipas ligjit, këshilltarët bashkiak janë të detyruar të konsultohen me komunitetin dhe grupet e interesit për vendimet përpara se si marrin ato.
- Dëgjesa Publike, të organizuara në përputhje me objektivin e përcaktuar nga ju, janë një mjet shumë i mirë për të bërë prezent problematikat që lidhen me çështjen specifike, për të propozuar ndryshime dhe për të nxitur vendimarrësit lokal për tu angazhuar në ndryshimin e situatës.
- Media është një rrugë jashtëzakonisht e rëndësishme për të ndikuar si mbi vendimarrësit për të reaguuar e iniciuar ndryshimet e nevojshme, ashtu dhe për të mobilizuar pjestarët e komunitetit në mbrojtje të interesave të të cilëve ju po angazhoheni, që të bëhen pjesë e ndryshimit të kërkuar.
- Rrjetet sociale, gjithnjë e më shumë po bëhen një rrugë e rëndësishme e komunikimit por mbani parasysh karakteristikat e grupit e interesat e të cilit përfaqësoni dhe mbron. Nëpërmjet medias sociale, ju mund të keni një impakt tepër të madh te qytetarët. Duke patur një kauzë tuajën për një çështje apo problematikë që shqetëson komunitetin, ju mund ta prezantoni atë në median sociale e cila ju lejon të përçoni mesazhin tuaj në kohë rekord dhe ka vizualitet tepër më madh duke filluar nga qytetarët e thjeshtë e deri te aktorët kryesorë. Nëpërmjet medias sociale ju keni mundësinë që të ndikoni duke solidarizuar e ndërgjegjësuar opinionin publik për çështje të tilla si aksesimi në shërbim më të mirë shëndetësor, në arsim, infrastrukturë etj.

### Rëndësia e aktivizmit qytetar

Koncepti i qytetarisë aktive<sup>3</sup> është koncepti sipas të cilit nënkuptohet angazhimi i individëve dhe grupeve në jetën dhe çështjet publike. Qytetaria aktive ka të bëjë me përfshirjen e individëve në jetën publike dhe çështjet që mund të bëhet në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Individët që aktivizohen në komunitetin e tyre, kanë mundësi që të jenë në kontakt të vazhdueshëm me aktorë të ndryshëm që kanë përgjegjësinë për të zbatuar dhe zhvilluar politikat vendimmarrëse, duke luajtur kështu një rol tepër të rëndësishëm në rritjen e transparencës të institucioneve përgjegjëse e duke ndikuar aftësitë e komunitetit për të reaguuar e për të qenë më të vëmendshëm në vendimet që merren nga institucionet e që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetesës për komunitetin. Disa shembuj të një qytetarie aktive mund të përmendim duke filluar nga pjesëmarrja në votime, drejtimi i ankesave/letrave për çështje të caktuara që shqetësojnë komunitetin, pjesëmarrja në mbledhjet e këshillit bashkiak, organizimi në grupe të ndryshme duke ushtruar presion etj.

Qytetarët kanë të drejtë që të angazhohen të iniciativa të ndryshme që ata gjykojnë se ka nevojë për ndërhyrje nga institucionet, siç mund të jenë shëndetësia, arimimi, infrastruktura, rritja e punësimit, rritja e transparencës nga institucionet politikbërëse për temën e buxhetit por edhe çështje të tjera që kanë nevojë për përmirësim. Në këtë mënyrë, qytetarët duke qenë aktiv, duke guxuar e reaguuar, ushtrojnë të drejtën e tyre të plotë që është në bazën e sistemit të demokracisë për të kërkuar më shumë llogari nga institucionet e duke patur kështu mundësinë për të qenë aktorë kryesorë në përmirësimin e jetesës së tyre në komunitet.

<sup>3</sup> Qytetaria aktive - Syri i Vizionit [www.syrivizionit.org](http://www.syrivizionit.org)